

VENDIM
Nr. 76, datë 14.4.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 222, DATË 23.10.2024, LIDHUR ME KËRKESËN
E SHOQËRISË “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” SHPK PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË
ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 64, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 259/4 prot., datë 1.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydropowerplant Construction’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2039 prot., datë 4.10.2024, paraqiti kërkesën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme, në funksion të garantimit të përmbushjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.

2. Fillimi i procedurës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 222, datë 23.10.2024, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kësaj kërkeje.

- Me shkresën nr. 2039/4 prot., datë 4.11.2024, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm dhe për mangësitë në dokumentacionin e depozituar.

- MIE u informua për këtë procedurë me shkresën nr. 2039/3 prot., datë 28.10.2024.

3. Kërkesa për pezullim

- Shoqëria, me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 2039/6 prot., datë 24.12.2024, paraqiti kërkesën për pezullimin e procedurës, duke argumentuar se ka pasur një vonesë të tejzgjatur nga banka për plotësimin e dokumentacionit.

- Me shkresën nr. 259 prot., datë 23.1.2025, ERE i kërkoi shoqërisë të bënte me dije mbi afatin, në lidhje me kërkesën për pezullimin e procedurës.

- Shoqëria, me shkresën nr. 259/1 prot., datë 12.2.2025, informoi se, si pasojë e mungesës së dakordësisë me bankën për vijimin e procesit të financimit, marrëveshja për kredi ishte ndërprerë.

- Në vijim të shkresës së ERE nr. 259/2 prot., datë 4.3.2025, shoqëria, me shkresën nr. 259/3 prot., datë 17.3.2025, informoi se heq dorë nga aplikimi për marrjen e autorizimit për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme dhe se, në rast të nënshkrimit të një marrëveshjeje të re me një bankë të nivelit të dytë, do të paraqesë një aplikim të ri.

4. Vlerësimi ligjor për përfundimin e procedurës

- Në përputhje me nenin 64, pika 2, të ligjit nr. 45/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, një palë ka të drejtë të tërhiqet nga procedura administrative përmes një kërkeje me shkrim, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes, organi publik vendos përfundimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 23.10.2024, “Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë ‘Hydropowerplant Construction’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti